



Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim dhe mbështetje të Komisionit të Lartë për refugjatë (UNHCR), Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (IFRC) dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq (KNKK) është i kyqur në lehtësimin e vuajtjeve të migrantëve të cilët tranzitojnë nëpër territoret e RM-së.

- Qershor 2015 ekipet patrulluese të Kryqit të kuq në autostradën Gjevgjeli-Kumanovë dhe ofrimi i ndihmës së parë një numri të madh të migrantëve
- Shtator 2015 janë të ndërtuara kampe në Vinojug-Gjevgjeli dhe Tabanovcë-Kumanovë, mobilizuan 11 ekipe me 264 vullnetarë të trajnuar në dhënien e ndihmës së shpejtë dhe shpërndarjen e ndihmës humanitare
- Kryqi i kuq siguron mbulim 24 orësh për nevojat e migrantëve
- Nga qershori i 2015 deri në mars 2016 janë të shpërndarë 491.966 shishe të ujit, 47.359 pako me ushqim, 15.936 pako higjienike, 53.492 batanije, 3.544 komplete për ndihmë të shpejtë, 13.149 xhaketa, 16.002 mushama
- 185.362 asistime të timeve të Kryqit të kuq për dhënen e ndihmës së parë

Kampanja “ Stop për indiferencën-Të ruajm humanitetin” fton njerëzit, partnerët dhe vendim marrësit në solidaritet me migrantët, për mbrojtjen e tyre dhe garantimin e sigurisë dhe dinjitetit të tyre, pa diskriminim, në çdo hap të udhëtimit.

Për më shumë informata:

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë

Adresa: Bul. Koço Racin nr 13 1000-Shkup, Republika e Maqedonisë

Telefon: +389 2 311 43 55

Faks: +389 2 323 05 42

WWW.REDCROSS.ORG.MK

 www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

 www.youtube.com/MacedonianRedCross



Стоп за рамнодушност - Да ја сочуваме хуманоста
Stop për indiferencën – Ta ruajm humanitetin
Stop Indifference – Save Humanity



Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë
Macedonian Red Cross



MISIONI I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

“Të ndalohet dhe lehtësohet vuajtja njerëzore kudo që është, ta mbron jetën dhe shëndetin, të sigurohet respekti dhe dinjiteti njerëzor, sidomos gjatë konflikteve të armatosura, aksidenteve dhe katasrofave, të punon për parandalimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e gjendjeve shëndetësore dhe sociale të njerëzve, të angazhon nxitjen vullnetare për dhënen e ndihmës si dhe ndjenjë univernale për solidaritet dhe humanitet”.

Migrantët përbëjnë 3% të popullatës së përgjithshme në botë. Kjo do të thotë se 1 në çdo 35 njerëz është një migrant.

Migrimi është një fenomen që mund të ndikojë në çdo vend. Shumica e migrantëve shpërngulen vullnetarisht dhe shumë prej tyre janë të detyruar të shpërngulen. Më shumë njerëz janë të detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre dhe shoqëritë e tyre për shkak të shumë faktorëve: konfliktet, ndjekjet, katastrofave natyrore dhe varfërisë. Migrimi pa dallim a është vullnetar apo i detyruar, involvon kombinim të vendimeve dhe kufizimeve.

Me qëllim që të arrijnë në një vend të caktuar, migrantët kalojnë nëpër teritoret e më shumë vendeve. Kështu, në gjithë Republikën e Maqedonisë, në periudhën prej muajit qershor të vitit 2015 deri në muajin mars të vitit 2016 kanë kaluar tranzit më shumë se 800.000 njerëz, qëllimi i të cilëve ka qenë të arrijnë në disa vende të Evropës perëndimore.

Të drejtat dhe obligimet e këtyre personave në **Republikën e Maqedonisë** janë të rregulluara me Ligjin për azil dhe mbrojtje të përkohëshme. Ligji nuk ofron definicion për kuptimin e "migrantëve", por, ju siguron të gjithë personave që do të hyjnë në teritorin e Republikës së Maqedonisë afat prej 72 orë të vendosin se a do të aplikojnë për azil, ose do të largohen nga vendi.

Zgjedhja e nevojave të migrantëve përmes alarmimit të publikut, ndihma dhe aksioni humanitar, mbrojtja dhe zmadhimi i vetëdijes është prioritet i rëndësishëm për Lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe



Sipas Fedaratës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, migrantët janë njerëz të cilët i kanë lënë apo janë larguar nga shtëpitë e tyre që të shkojnë në një vend tjetër, shpeshherë jashtë shtetit, në kërkim të mundësive, ndihmës ndërkombëtare ose jetës më të mirë dhe më të sigurtë... dhe ka të bëjë me të gjitha kategoritë të migrantëve siç janë migrantët ekonomik, migrantët pa shtetësi, migrantët ilegal, të ikurit dhe kërkuesit e azilit. Lëvizja nuk ka asnjë rol në përcaktimin e statusit ligjor të emigrantëve.

Gjysmëhënës së kuqe dhe të Kryqit të kuq të R.Maqedonisë.

Mbrojtja dhe ndihma humanitare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe për migrantët ka të bëjë me shpërndarjen e ndihmës humanitare, rripërrirjen e lidhjeve familjare, sigurimin e këshillave psikologjike, shërbime shëndetësore, integritet, ymadhimin e vetëdijes për kuptimin e migrimit dhe zvogëlimin e stigmeve dhe stereotipeve për migrantët, integritet dhe masat për trajnim.